



PAS AKTGJYKIMIT TË KUSHTETUESES, TOPI TE MARRËVESHJA POLITIKE OSE PRESIDENTJA

IFAGE 4



Ekspertët e çështjeve ligjore-kushtetuese thonë se aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese nuk solli zgjidhje për krizën institucionale në Kosovë.

Sipas tyre, zgjidhja tani mund të vijë vetëm përmes një marrëveshjeje politike ose me ndërhyrjen e presidentes. Gjykata Kushtetuese e Kosovës dha

urdhrin, por në Kuvend nuk ka as zbatim as marrëveshje. Edhe të martën, për herë të 40, deputetët e zgjedhur dështuan ta konstitujnë institucionin ligjvënës

MOSKONSTITUIMI I KUVENDIT, OVLUÇK-ja: UÇK-JA NUK LUFTOI PËR BLOKADË POLITIKE, KOSOVA ËSHTË PËRGJEGJËSI E TË GJITHËVE F.3



BE-ja NDËRRON DREJTUES, KOSOVA NË VENDNUMËRO F.5



AKTUALE



KURTI NË SHKUP KËRKON QË KOSOVËS T'I GARANTOHET QASJE E BARABARTË NË PROGRAMET DHE INSTRUMENTET E BE-së F.6

ME INICIATIVË TË PRESIDENTES OSMANI DHE ME MBËSHETJEN E KATARIT, INVALIDËT E LUFTËS DO TË PAJISEN ME PROTEZA ORTOPEDIKE F.3

SHAIK KAMBERI THOTË SE DO T'I BOJKOTOJË PUNIMET E ARDHSHME TË KUVENDIT TË SERBIË F.6

EKONOMI



VETËM NË MUAJIN MAJ JANË RËGJISTRUAR 1 333 NDËRMARRJE TË REJA F.8

DHTIK KËRKON ZGJIDHJE URGJENTE PËR BLOKIMIN E REGJISTRIMIT TË AUTOMJETEVE TË BIZNESEVE F.8

SPORT



SOT FILLON KAMPIONATI EVROPIAN U16 I VOLEJBOLLIT, ORGANIZOHET NË PRISHTINË E TIRANË F.10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kos në Shkup: Plani i Rritjes është plotësisht në duart tuaja

SHKUP, 1 KORRIK - Komisionarja evropiane për Zgjerim, Marta Kos, zhvilloi të martën në Shkup një takim me liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor, në kuadër të Samitit të dedikuar Planit të Rritjes së Bashkimit Evropian prej 6 miliardë eurosh për këtë rajon.

Nga Plani i Rritjes, të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor - përveç Kosovës dhe Bosnje e Hercegovinës - kanë marrë fondet e para të parafinancimit. Kosovën në këtë takim e përfaqëson kryeministri në detyrë, Albin Kurti.

Në një konferencë për medie pas takimit të së martës, komisionarja Kos tha se për herë të parë ky samit ishte i fokusuar në zbatimin e Planit të Rritjes. Ajo bëri me dije se 75 për qind e reformave të dakorduara - të përbashkëta për të gjitha vendet e rajonit - janë ose të zbatuara plotësisht ose janë në proces, ndërsa 25 për qind ende mbeten për t'u realizuar. "I inkurajova liderët ta shtojnë përkushtimin për zbatimin e mëtejshëm", tha Kos.

Ajo shtoi se mjetet financiare që janë vënë në dispozicion për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor do të jenë të qasshme deri në fund të vitit 2027 dhe, nëse nuk shfrytëzohen, do të kthehen në buxhetin e BE-së.

Kos theksoi disa rezultate konkrete të arritura deri më tani, përfshirë përparimin drejt SEPA-s (Zona e Vetme e Pagesave në Euro), një sistem që lehtëson kryerjen e pagesave brenda hapësirës evropiane. Sipas saj, katër vende të Ballkanit Perëndimor janë në rrugë për



t'u bashkuar së shpejti këtij sistemi.

Kos përmendi edhe krijimin e 11 pikave kufitare prioritare me kalime të gjelbra, që synojnë ta lehtësojnë lëvizjen e mallrave. Përveç kësaj, sistemi satelitor i BE-së, Galileo, do të përdoret për të gjurmuar kamionët në kohë reale, duke mundësuar kuptimin më të mirë të vonesave dhe dinamikës së qarkullimit. "Edhe më shumë po vjen në kuadër të autostradës drejt tregut unik", shtoi ajo. "Po punojmë së bashku për të identifikuar zinxhirët evropianë të furnizimit, në të cilët kompanitë tuaja mund të integrohen. Për shembull, në sektorin farmaceutik, do t'ju ndihmojmë të përshtateni me standardet e BE-së, në mënyrë që bizneset tuaja të trajtohen njësoj si ato të vendeve anëtare".

Sipas Kos, projektet që financohen nga Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor do të mbështesin ndërtimin e rrugëve, linjave hekurudhore, si dhe parqeve me erë dhe diell në të gjithë rajonin. Në kuadër të kësaj kornize, Komisioni Evropian ka propozuar një paketë investimi prej 87.7 milionë eurosh, që pritet të mobilizojë gjithsej 487.3 milionë euro për projekte të energjisë së pastër në Shqipëri, Mal të Zi dhe Serbi. Fondi parashikon ndërtimin e linjave të transmissioinit dhe nënstacioneve në Shqipëri dhe Mal të Zi, rehabilitimin e hidrocentraleve në Shqipëri dhe Serbi, si dhe integrimin e ngrohjes solare në sistemin e ngrohjes qendrore në Novi Sad, Serbi.

Ajo shtoi se në takim është diskutuar edhe për roaming-un

për telefoninë mobile, duke theksuar se, nëse të gjitha vendet punojnë me përkushtim në zbatimin e reformave dhe ndryshimet në legjislacion, roaming-u pa pagesë për vendet e Ballkanit Perëndimor mund të hyjë në fuqi më 1 janar 2026.

Në fjalën hyrëse të samitit, komisionarja Kos tha se Evropa nuk mund të jetë e bashkuar pa Ballkanin Perëndimor.

Ajo shtoi se tani ekziston një konsensus i qartë për zgjerimin, gjë që nuk ka qenë e njëjtë në të kaluarën, por "dritarja e mundësisë nuk do të jetë e hapur përgjithmonë". "Po shohim përparim të rëndësishëm. Shqipëria, i dashur kryeministër Edi Rama, ka hapur tre klasterë gjatë gjashtë muajve të fundit. Faleminderit për kontributin tuaj në suksesin e procesit të

zgjerimit. Nëse vazhdojmë me këtë ritëm, do të mund t'i hapim të gjithë klasterët këtë vit. Ndërkohë, Mali i Zi mbylli edhe një kapitull të premten e kaluar. Në Bosnje e Hercegovinë është miratuar agenda e reformave dhe po presim që qeveria e re, z. Kurti, të vendosë më në fund më shumë energji në procesin e anëtarësimit. Ndërkohë, tashmë po ecim përpara edhe me Serbinë", tha ajo.

Kos tha se Plani i Rritjes është plotësisht në duart e tyre. "Ky është një mjet për t'ju ndihmuar me reformat e rëndësishme, të cilat janë të domosdoshme edhe për t'ju përgatitur për anëtarësim. Njëkohësisht, ky plan ju mundëson që qytetarët dhe bizneset tuaja të përfitojnë nga tregu unik i BE-së, në kushte të barabarta me vendet anëtare. Dhe kjo, tani - jo në një të ardhme të largët", theksoi ajo.

Ajo shtoi se vendet kanë bërë shumë, por tani është koha të intensifikohet faza e zbatimit. Kos shtoi se kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, është pajtuar që të jetë mikpritës i takimit të radhës të liderëve, që do të mbahet në vjeshtë në Shqipëri.

Plani, i miratuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli i BE-së në maj të vitit 2024 dhe i aprovuar përfundimisht në tetor të po atij viti, kap vlerën prej gjashtë miliardë eurosh. Ai përfshin investime dhe reforma për vendet e Ballkanit Perëndimor si pjesë e agjendës reformuese për periudhën 2024-2027.

Një pjesë e këtyre fondeve do të jepet si grante dhe pjesa tjetër në formën e kredive me kushte të favorshme.

Gjykata serbe e shpall të pafajshëm ish-komandantin e ushtrisë së Republikës Sërpska për krime në Srebrenicë

BEOGRAD, 1 KORRIK - Gjykata e Lartë në Beograd e ka shpallur të pafajshëm ish-komandantin e Korpusit të Drinës të Ushtrisë së Republikës Sërpska (VRS), Milenko Zhivanoviq, për akuzat për krime lufte kundër popullatës civile në Srebrenicë, në korrik të vitit 1995. Gjykata e shpalli atë të pafajshëm në shkallën e parë në një aktgjykim të martën, duke e liruar nga akuza se kishte urdhëruar zhvendosjen e detyruar të popullsisë boshnjake nga zona e mbrojtur e Srebrenicës.

Prokuroria ka paralajmëruar se do të ankohet ndaj këtij vendimi. Në arsyetimin e aktgjykimit, gjyqtarja deklaroi se Zhivanoviq, si komandant, u kishte dhënë

detyra njërive të Korpusit të Drinës, por sipas saj, asnjë prej këtyre detyrave nuk lidhej me dëbimin e popullsisë civile boshnjake, por kishin të bënin me veprime luftarake kundër njërive të palës kundërshtarë. Prokuroria kishte kërkuar dënim me pesë vjet burgim për Zhivanoviqin - që është minimumi i paraparë me ligj. Ndër të tjera, aktakuza e ngarkonte atë se, në mars të vitit 1995, kishte lëshuar një urdhër ku thuhej se "me veprime të përditshme të planifikuara dhe të menduara luftarake duhet të krijohen kushte të pasigurisë totale, të padurueshmërisë dhe të pashpresës për vazhdimin e jetës së banorëve në Srebrenicë

dhe Zhepë".

Aktakuza e ngarkonte atë gjithashtu se, më 12 korrik 1995, kishte urdhëruar sigurimin e autobusëve për evakuimin nga enklava e Srebrenicës, duke kërkuar nga Shtabi i Përgjithshëm i VRS-së miratimin për përdorimin e karburantit për 50 autobusë që do të angazhoheshin.

Forcat e Ushtrisë së Republikës Sërpska, gjatë ofensivës kundër Srebrenicës - zonë e mbrojtur nga Kombet e Bashkuara - në korrik të vitit 1995 kryen gjenocid duke vrarë mbi 8 000 burra dhe djem boshnjakë. Gjatë gjithë procesit gjyqësor në Serbi, Milenko Zhivanoviq u mbrojt në liri.



Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

MOSKONSTITUIMI I KUVENDIT, OVLUÇK-JA: UÇK-JA NUK LUFTOI PËR BLOKADË POLITIKE, KOSOVA ËSHTË PËRGJEGJËSI E TË GJITHËVE

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 KORRIK - Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka reaguar lidhur me ngërçin politik në vend, gjersa thekson se Kosova është përgjegjësi e të gjithëve dhe askush nuk ka të drejtë ta mbajë peng. OVLUÇK-ja përmes një komunikate për medie thekson se është e papranueshme që, në kohën kur qytetarët përballen me sfida të mëdha ekonomike, sociale dhe të sigurisë, partitë politike, në veçanti partia fituese, të mbajnë një qëndrim të ngurtë dhe të pandjeshëm ndaj përgjegjësisë kushtetuese për konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe formimin e institucioneve legjitime të vendit. “Në emër

të idealit të luftës për liri dhe shtetndërtim, në emër të atyre që dhanë gjithçka për ta parë Kosovën të lirë, sovranë dhe demokratike, OVL, SHIL, SHFD të UÇK-së, Shoqatës së të Burgosurve Politikë dhe Shoqëria ‘Lëvizja’ shprehim shqetësimin tonë të thellë lidhur me krizën institucionale që po thellohet si pasojë e një ngërçi politik të panevojshëm. Është e papranueshme që, në kohën kur qytetarët përballen me sfida të mëdha ekonomike, sociale dhe të sigurisë, partitë politike, e në veçanti partia fituese, të mbajnë një qëndrim të ngurtë dhe të pandjeshëm ndaj përgjegjësisë kushtetuese për konstituimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe formimin e institucioneve legjitime të vendit”, thuhet në reagim. OVLUÇK thekson se nuk



paragjykon asnjë kandidat për pozitën institucionale, por kur interesi shtetëror dhe funksionimi i demokracisë vihet në rrezik për shkak të mungesës së kompromisit dhe kryeneçësisë politike, atëherë ndien për detyrë ta ngrehë zërin publikisht. “U bëjmë thirrje të gjitha subjekteve politike, në veçanti partisë fituese, të tregojë pjekuri

politike dhe përgjegjësi shtetërore, duke i dhënë fund krizës aktuale përmes një zgjidhjeje të qëndrueshme, që respekton frymën dhe shkronjën e Kushtetutës, si dhe vullnetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës. UÇK-ja nuk luftoi për bllokada politike. Nuk luftoi për interesa të ngushta dhe për ngërçe që paralizojnë

institucionet. Ne luftuam për një Kosovë të lirë, demokratike dhe funksionale, me institucione që i shërbejnë qytetarit, jo logjikës së pushtetit me çdo kusht”, thuhet në reagim, duke shtuar se: “Nëse kriza institucionale vazhdon dhe cenon më tej rendin demokratik dhe stabilitetin e vendit, ne, OVL, SHIL, SHFD të UÇK-së, Shoqatës së të Burgosurve Politikë dhe Shoqëria ‘Lëvizja’ do të ndiejmë për obligim që të ndërmarrim hapa të mëtejshëm publikë, institucionalë dhe qytetarë, për të mbrojtur vlerat për të cilat u sakrifikuam shumë dhe për të garantuar funksionimin e shtetit në frymën e Kushtetutës. Kosova është përgjegjësi e të gjithëve, dhe askush nuk ka të drejtë ta mbajë peng”, është theksuar në reagimin e OVLUÇK-së.

ME INICIATIVË TË PRESIDENTES OSMANI DHE ME MBËSHTETJEN E KATARIT, INVALIDËT E LUFTËS DO TË PAJISEN ME PROTEZA ORTOPEDIKE

PRISHTINË, 1 KORRIK - Falë angazhimit të drejtpërdrejtë të presidentes së Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, dhe me mbështetjen e Qatar Fund for Development në bashkëpunim me Gjysmëhënën e Kuqe të Katarit, kanë filluar ekzaminimet mjekësore në Kosovë për invalidët e luftës, si pjesë e një projekti që do t'i pajisë ata me proteza ortopedike të avancuara dhe trajtim mjekësor të specializuar. Presidenca ka njoftuar se ky projekt përfaqëson më shumë



sesa ndihmë mjekësore - është një akt konkret falënderimi për ata që kanë sakrifikuar

gjymtyrët e tyre për lirinë e Kosovës. “Ata nuk kanë humbur vetëm një pjesë të trupit, por

kanë bërë sakrificën më të dhimbshme në ndjekje të idealit më të lartë: lirisë dhe pavarësisë së vendit tonë. Kjo iniciativë është dëshmi e përkushtimit të palëkundur të Presidentes për të qëndruar pranë atyre që kanë dhënë gjithçka për shtetin tonë, duke e shndërruar kujdesin ndaj tyre në një prioritet kombëtar dhe moral”, ka njoftuar Presidenca. Presidentja Osmani ka shprehur mirënjohje të thellë ndaj Qatar Fund dhe Gjysmëhënës së Kuqe të Katarit për këtë mbështetje të

jashtëzakonshme, duke theksuar se kujdesi për invalidët e luftës është një detyrim moral, shtetëror dhe njerëzor. “Ky bashkëpunim, po ashtu, forcon marrëdhëniet miqësore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shtetit të Katarit, duke dëshmuar se solidariteti ndërkombëtar, i mbështetur nga udhëheqja e presidentes, mund të sjellë ndryshime të prekshme dhe dinjitoze në jetën e atyre që mbrojtën lirinë me sakrificën më të lartë”, ka njoftuar Presidenca.

53 RASTE TË KËRCËNIMEVE DHE SULMEVE NDAJ GAZETARËVE NË VITIN 2024

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 KORRIK - Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës (AGK) ka paraqitur raportin dhe indeksin vjetor për lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve në Kosovë, i cili publikohet në kuadër të platformës SafeJournalists Network. Raporti u paraqit nga autorja dhe hulumtuesja, njëkohësisht drejtuesja ekzekutive e AGK-së, Getoarbe Mulliqi. Pjesë e panelit ishin edhe kryetari i Bordit të AGK-së, Xhemajl Rexha, dhe zyrtari Ligjor i AGK-së, Yll Zekaj, i cili

ka shërbyer ekspert ligjor në përgatitjen e raportit. Gjetjet kryesore të raportit për vitin 2024 përfshijnë: 53 raste të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve, përfshirë 9 kërcënime serioze për jetë, 7 sulme fizike dhe 18 forma të presionit jofizik. Rritje e rasteve të sulmeve në ambientin online, veçanërisht ndaj grave gazetare. 13 raste të sulmeve, ndërhyrjeve apo presionit ndaj medieve dhe organizatave mediale. Ndërhyrje politike shqetësuese ndaj medieve, përfshirë presione të drejtpërdrejta ndaj RTK-së që kulmuan me dorëheqjen e

drejtorit të përgjithshëm Shkumbin Ahmetxhekaj, si dhe sulme verbale dhe ligjore ndaj medieve nga zyrtarë shtetërorë. “Rritje e padive SLAPP ndaj gazetarëve e aktivistëve: rastet e Robert Bojaj, Ardiana Thaçi Mehmeti, Betim Musliu, Ehat Miftarit dhe Leonida Molliqajt janë dëshmi e tentimeve për heshtjen e raportimit kritik dhe aktivizmit publik. Themelimi i Rrjetit të Grave Gazetare të Kosovës si një iniciativë thelbësore për fuqizimin dhe mbrojtjen e gazetarëve në mungesë të një sindikate funksionale. Diskutimi u zhvillua me



gazetare nga gjithë vendi, si dhe përfaqësues të organizatave vendore dhe ndërkombëtare që punojnë për lirinë e shprehjes dhe të drejtën për informim”, ka

njoftuar AGK-ja. AGK-ja ritheksion angazhimin e vet për t'i mbrojtur të drejtat e gazetarëve dhe për t'i avancuar standardet e gazetarisë së lirë dhe të sigurt në Kosovë.



PAS AKTGJYKIMIT TË KUSHTETUESES, TOPI TE MARRËVESHJA POLITIKE OSE PRESIDENTJA

PRISHTINË, 1 KORRIK - Ekspertët e çështjeve ligjore-kushtetuese thonë se aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese nuk solli zgjidhje për krizën institucionale në Kosovë. Sipas tyre, zgjidhja tani mund të vijë vetëm përmes një marrëveshjeje politike, ose me ndërhyrjen e presidentes. Gjykata Kushtetuese e Kosovës dha urdhrin, por në Kuvend nuk ka as zbatim as marrëveshje. Edhe të martën, për herë të 40, deputetët e zgjedhur dështuan ta konstituojnë institucionin ligjvënës. Ndërkohë që afati prej 30 ditësh - i përcaktuar nga Kushtetuesja për përmbylljen e konstituimit - ec, ata mbeten të bllokuar në mosmarrëveshje të thella politike. Njohësit e çështjeve ligjore-kushtetuese paralajmërojnë se nëse Kuvendi nuk e përmbyll këtë proces deri më 26 korrik - kur skadon afati i Kushtetueses - Kosova rrezikon të përfshihet nga një paralizë e tërësishme institucionale. Mazllum Baraliu, profesor i së Drejtës Kushtetuese, thotë se përgjegjësia për situatën aktuale nuk qëndron vetëm te partitë politike, por edhe te vet vendimi i Gjykatës Kushtetuese. “Gjykata

Kushtetuese nuk i ka precizuar sa duhet dhe si duhet gjërat, në mënyrë që të mos lejojë hapësirë për interpretimin e secilit, sipas tekeve dhe qejfeve të veta”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë. Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, i thirri në takim përfaqësuesit e partive politike, në përpjekje për të zhblokuar situatën, por pas më shumë se dy orësh diskutime më 28 qershor, takimi përfundoi pa kompromis - me secilën palë duke fajësuar tjetrën dhe duke interpretuar në mënyra të ndryshme vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Ehat Miftaraj, drejtor ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi, thotë se aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk ofron qartësi për veprimet që duhet ndërmarrë, nëse Kuvendi nuk arrin të konstituohet brenda afatit. Ai paralajmëron se partitë mund të vazhdojnë bllokadën dhe përplasjet, duke ia atribuuar fajin njëra-tjetrës, ndërsa pas 26 korrikut situata mbetet e pasigurt. “Aktgjykimi nuk ka paraparë asnjë lloj pasoje, në qoftë se (konstituimi i Kuvendit)

nuk ndodh deri më 26 korrik apo brenda 30 ditësh, siç është paraparë afati ligjor”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

Marrëveshja politike, e domosdoshme

Për ta tejkaluar këtë bllokadë, njohësit e çështjeve juridike-kushtetuese vlerësojnë se është e domosdoshme arritja e një marrëveshjeje politike ndërmjet subjekteve parlamentare. Miftaraj thotë se barra kryesore e përgjegjësisë për shfaqjen e vullnetit politik për marrëveshje, bie mbi partinë që fitoi më së shumti vota në zgjedhjet e 9 shkurtit - Lëvizjen Vetëvendosje të Kurtit. “Fatkeqësisht, kjo (situatë) mund të zgjasë deri në kohën kur partia në pushtet apo Albin Kurti të vendosë që ta ndërrojë kandidatin (për kryetar të Kuvendit) dhe të ofrojë zgjidhje”, thotë ai. Baraliu ndan mendim të ngjashëm, por thekson se nga kjo përgjegjësi nuk përjashtohen as partitë tjera kryesore, si: Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës apo Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

Sipas tij, edhe pse nuk ka sanksione ligjore për mosarritjen e marrëveshjes për konstituimin e Kuvendit deri më 26 korrik, partitë mbajnë përgjegjësi politike, etike dhe morale përpara qytetarëve që i kanë zgjedhur. “Partitë politike janë institucione. Përgjegjësia politike, etike dhe morale do të duhej të ishte po aq - në mos edhe më shumë - sa ajo penale”, thekson Baraliu. Kurti u tha gazetarëve më 30 qershor se është i gatshëm për takime dhe konsultime konstruktive me partitë tjera politike, si dhe për bashkëpunim në frymë mirëbesimi. Ai përsëriti se, nëse Albulena Haxhiu nuk zgjidhet kryeparlamentare përmes votimit të fshehtë, Lëvizja Vetëvendosje është e hapur për ta ndryshuar kandidatin. Haxhiu, për disa herë me radhë, nuk arriti t'i merrte 61 votat e domosdoshme për kryeparlamentare. Partitë e tjera insistojnë në votim të hapur, ndaj edhe nuk i janë përgjigjur kërkesës së vazhdueshme të kryesuesit të seancës konstituive, Avni Dehari, për të propozuar

përfaqësues për komisionin që do të mbikëqyrte votimin e fshehtë.

Presidentja?

Duke marrë parasysh se partitë politike, aktualisht, nuk po tregojnë vullnet për të tejkaluar bllokadën në konstituimin e Kuvendit, një nga adresat që duhet ta trajtojë këtë situatë është presidentja e Kosovës, vlerëson Miftaraj. Sipas tij, presidentja Vjosa Osmani ka mandat për të siguruar funksionimin demokratik të institucioneve kushtetuese. Në rastin konkret, funksionimi i Kuvendit nuk po ecën siç duhet, prandaj Osmani mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, thotë ai. “Ajo mund të kërkojë dhe dërgojë pyetje lidhur me atë se a është abuzim kjo që po bën partia në pushtet - duke mos e ndërruar kandidatin e propozuar - për të bërë konstituimin e Kuvendit”, thotë Miftaraj. Bekim Kupina, këshilltar për media i presidentes Osmani, bëri të ditur se ajo do t'i ftojë udhëheqësit e partive politike në

BE-ja NDËRRON DREJTUES, KOSOVA NË VENDNUMËRO

PRISHTINË, 1 KORRIK - Nga 1 korriku Danimarka mori drejtimin e Presidencës së Këshillit të Bashkimit Evropian, duke trashëguar një numër dosjesh të rëndësishme politike, ndër to edhe njëra që prej kohësh ka mbetur mënjanë: aplikimi i Kosovës për anëtarësim në BE. I dorëzuar qysh në dhjetor të vitit 2022, ky aplikim nuk ka kaluar as në fazën e parë formale - shqyrtimin nga Këshilli i BE-së dhe më pas dërgimin për opinion te Komisioni Evropian. Në kushte normale kjo do të ishte një procedurë më rutinore. Por, në rastin e Kosovës - që ende nuk njihet nga pesë shtete anëtare - gjithçka është e ndërlikuar nga kalkulimet politike, hezitimet diplomatike dhe mungesa e vullnetit për ta trajtuar këtë çështje më me seriozitet. Kosova është i vetmi shtet në Ballkanin Perëndimor që nuk e ka statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE - një fakt që pasqyron qartë stagnimin e agjendës së saj evropiane. Pyetja tani është nëse presidenca daneze do të merret me këtë dosje, apo do të ndjekë edhe ajo rrugën e paraardhësve, duke e lënë në pritje pa afat. Këtij interesimi të Radios Evropa e Lirë ajo nuk iu përgjigj, por njohësit e këtyre proceseve nuk presin ndonjë ndryshim domethënës gjatë gjashtëmujorit

të saj. “Për momentin, nuk ka asgjë konkrete, asnjë lëvizje. Danezët donin shumë t’i lëviznin gjërat përpara, por, për fat të keq, nuk patën asnjë ndihmë nga ana e Kosovës”, thotë Rikard Jozwiak, redaktor për Evropën i Radios Evropa e Lirë. Ai shpjegon se vështirësia kryesore nuk lidhet vetëm me skepticizmin e disa shteteve anëtare ndaj Kosovës, por edhe me vetë gjendjen politike në Prishtinë. Kujton se Kosova, prej muajsh, funksionon me institucione në detyrë, apo pa një qeveri të konsoliduar, që do të mund të rifillonte seriozisht angazhimin me BE-në. Për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, thotë se Kosova nuk ka bërë asnjë lëvizje domethënëse tash e gati dy vjet, duke mbetur në vendnumëro edhe në këtë proces - jetik për të ardhmen e saj evropiane. “Ndaj, do të jetë shumë vështirë të binden vendet skeptike ndaj Kosovës, sepse ajo, realisht, nuk është një prej atyre vendeve në Ballkan ku ka zhvillime pozitive”, thotë Jozwiak. Edhe pse zgjedhjet u mbajtën në shkurt, Kosova vazhdon të jetë pa Kuvend të konstituuar dhe, për rrjedhojë, pa qeveri të formuar, për shkak të mosmarrëveshjeve ndërmjet partive kryesore. Normalizimi i marrëdhënieve

është kusht i domosdoshëm si për Kosovën, ashtu edhe për Serbinë, për të ecur përpara në rrugën e integritetit evropian. Megjithatë, kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka refuzuar të takohet me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, që nga sulmi në Banjskë në shtator të vitit 2023, duke kërkuar më parë dorëzimin e të akuzuarve për atë ngjarje. Kjo qasje e ka vështirësuar dialogun dhe ka ndikuar në një qëndrim më kritik të BE-së ndaj Kosovës. Kurt Bassuener, nga Këshilli për Politikën e Demokratizimit në Berlin, thotë se politika e BE-së, e fokusuar kryesisht në dialogun e Kosovës me Serbinë, është e dëmshme për Kosovën, pasi, siç thotë, ka sjellë presion të njëanshëm ndaj saj dhe trajtim më lehtësues për Serbinë. Kjo, sipas tij, ka krijuar pabarazi në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe shpjegon arsyet përse: “Përputhshmëria e Kosovës me politikën e jashtme të BE-së, edhe pse nuk është vend kandidat, është shumë më e mirë se ajo e Serbisë, e cila është kandidatë. Orientimi gjeopolitik i Kosovës është i pakontestueshëm në të gjithë spektrin e ndarë të partive”. Për Bassuenerin, është thelbësore që Serbisë t’i bëhet e qartë se pa e njohur Kosovën si

shtet të pavarur, rruga e saj drejt BE-së do të ngecë. Në këtë mënyrë, thotë se BE-ja duhet të ushtrojë presion të barabartë ndaj Beogradit dhe t’i heqë masat ndëshkuese ndaj Prishtinës, të vendosura qysh pas tensioneve në veri, në vitin 2023. Pa këta hapa, dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk do të arrijë përparim të qëndrueshëm, thotë Bassuener, duke theksuar rëndësinë e një ndryshimi rrënjësor në politikën e BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor. “Danimarka mund të katalizojë një koalicion më të gjerë të vendeve anëtare për të detyruar një rishikim të politikës evropiane ndaj Ballkanit Perëndimor në tërësi. Prej saj do të përfitonte jo vetëm Kosova, por edhe ata që, aktualisht, mbështesin një Serbi të qeverisur në përputhje me vlerat themelore të BE-së”, thotë Bassuener. Bashkimi Evropian, për herë të fundit, është zgjeruar me Kroacinë në vitin 2013. Jozwiak thotë se blloku, aktualisht, është i fokusuar në çështje të tjera më prioritare, si armatosja e Ukrainës, ndërsa politikën e zgjerimit e ka kufizuar vetëm tek ato vende që kanë arritur përparime të dukshme, si Shqipëria dhe Mali i Zi. “Këto dy vende mund të përparojnë edhe

më tej, por pothuajse të gjitha të tjerat, për arsye të ndryshme, do të mbeten ku janë edhe gjatë presidencës daneze”, thotë ai. Jozwiak parashikon që prioritetet e presidencës daneze të jenë mbështetja ushtarake për Ukrainën, si dhe arritja e një marrëveshjeje tregtare me SHBA-në për të shmangur tensionet ekonomike transatlantike. Përveç kësaj, do të fillojë edhe procesin e negociimit për buxhetin e ri afatgjatë të BE-së, thotë ai. Danimarka e mori kryesimin e BE-së nga Polonia, e cila e kishte në gjashtë muajt e parë të këtij viti. Para saj në krye ishin: Hungaria, Belgjika, Spanja, Suedia, Çekia... Si kryesuese në gjysmën e dytë të 2022-shit, Çekia e pranoi aplikimin e Kosovës për anëtarësim në BE më 15 dhjetor të atij viti. Por, asnjë vend pas saj nuk e shqyrtoi, as s’e çoi përpara. Me rregullore, detyrën për ta futur në shqyrtim aplikimin e një vendi për anëtarësim në BE, e ka presidenca e Këshillit të BE-së, e cila çdo gjashtë muaj ndërrohet mes vendeve anëtare. Por, me këtë ritëm, duket se Kosova do të vazhdojë të presë në radhën e gjatë të çështjeve ‘prioritare’ të BE-së - aty ku presin edhe premtime të tjera të pambajtura.



takime gjatë ditëve në vijim. Ai tha se Osmani pret që partitë e përfaqësuar në Kuvend të zbatojnë aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese dhe të përfundojnë seancën konstituive brenda afatit prej 30 ditësh, siç kërkohet nga Gjykata. “Nëse paraqitet nevoja, presidentja mbetet e gatshme t’i drejtohet Gjykatës

Kushtetuese për sqarime shtesë”, tha Kupina më 30 qershor. Por, Baraliu konsideron se presidentja po vonohet me trajtimin e paralizës në Kuvend. “Duhet para këtyre 30 ditëve (para 26 korrikut) ta iniciojë procedurën në Gjykatën Kushtetuese. Me Kushtetutë

është e autorizuar t’i iniciojë çështjet që janë kontestuese dhe të paqarta mes palëve”, thekson ai. Të hënën, mbi 50 organizata të shoqërisë civile reagues ndaj bllokimit të konstituimit të Kuvendit, duke theksuar se “vakuumi institucional po çon në mosfunksionim të

institucioneve kushtetuese”. Organizatat nënvizuan se partia fituese ka të drejtën të propozojë kandidatin për kryetar, por kjo e drejtë nuk është absolute, pasi duhet të bashkëpunojë me partitë e tjera për të siguruar shumicën e nevojshme. Sipas tyre, Kushtetuesja e ka bërë të qartë se si partia fituese,

ashtu edhe partitë e tjera duhet të bashkëpunojnë në mirëbesim për të zgjedhur kryetarin e Kuvendit dhe se “shkelja e këtij parimi është shkelje e frymës së Kushtetutës”. Për t’u konsideruar i konstituuar Kuvendi, duhet që kryetari dhe pesë nënkryetarët të marrin të paktën 61 vota nga deputetët.

KURTI NË SHKUP KËRKON QË KOSOVËS T'I GARANTOHET QASJE E BARABARTË NË PROGRAMET DHE INSTRUMENTET E BE-së

SHKUP, 1 KORRIK - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, mori pjesë në takimin e liderëve të Ballkanit Perëndimor për Planin e Rritjes, që u mbajt në Shkup të Maqedonisë së Veriut, me tematikën “Stabiliteti, uniteti dhe e ardhmja”.

Ai udhëtoi të hënë në mbrëmje për në Shkup, për të qenë pjesë e darkës me liderët pjesëmarrës në samit, të shtruar nga kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Mickoski, ndërsa Kurti ishte pjesë e panelit të parë të diskutimit ndërmjet liderëve me temën “Plani i rritjes: vlerësim, puna e ardhshme dhe komunikimi”. Në fjalën e tij ai vlerësoi Planin e Rritjes të Bashkimit Evropian si një hap të rëndësishëm, duke theksuar se mbështetja e BE-së për vendet e rajonit duhet të jetë në përputhje me përkushtimin e tyre ndaj reformave, progresit demokratik dhe vlerave të përbashkëta evropiane. Në këtë kuadër ai kërkoi që Kosovës t'i garantohet qasje e barabartë në programet dhe instrumentet e Bashkimit Evropian.

Kryeministri Kurti rikonfirmoi mbështetjen e Kosovës për nismat e BE-së në kuadër të Planit të Rritjes, përfshirë turizmin, mbrojtjen e konsumatorit dhe “Autostradën e Tregut të Përbashkët”, ndërsa propozoi tre sektorë të tjerë me potencial bashkëpunimi: shërbimet digjitale konkurruese, përfshirë zhvillimin e softuerëve, sigurinë kibernetike, inteligjencën artificiale dhe teknologjitë e strukturuara; sektorin e mbrojtjes; dhe sektorin e bujqësisë dhe përpunimit të ushqimit. Për këtë nismë, ai shtoi se nearshoring-u duhet të jetë gjithashtu i orientuar drejt partnerëve të besueshëm (friendly shoring), dhe se kjo është një mundësi e madhe jo vetëm për rajonin tonë, por edhe për Bashkimin Evropian.

Ai theksoi disa fusha të progresit që nga takimi i fundit në Kotor, përfshirë edhe kryesimin e Kosovës në CEFTA. Gjithashtu, bëri thirrje për zbatimin e marrëveshjeve të arritura në Procesin e Berlinit, përfshirë atë për diploma dhe lëvizje të lirë me letërnjoftime. Kurti ka pohuar se



pas vendimit për heqjen e vizave, hyrjet nga qytetarët e Bosnje dhe Hercegovinës në Kosovë u rritën dukshëm. “Meqë qytetarët boshnjakë udhëtojnë lirshëm në Kosovë, edhe qytetarëve të Kosovës duhet t'u mundësohet e njëjta liri në Bosnje dhe

Hercegovinë”. Në përmbyllje, kryeministri Kurti theksoi se siguria është parakusht për zhvillim dhe rritje, duke vënë në pah se Ballkani Perëndimor nuk është i shkëputur nga rrafshi gjeopolitik i Evropës. Ai mirëpriti

angazhimin e Shteteve të Bashkuara për të parandaluar Iranin që të pajiset me armë bërthamore, si dhe vendimin e anëtarëve të NATO-s në Samitin e Hagës për t'i rritur shpenzimet për mbrojtje në 5 % të Bruto Prodhimit Vendor.

SHAIP KAMBERI THOTË SE DO T'I BOJKOTOJË PUNIMET E ARDHSHME TË KUVENDIT TË SERBISË

PRISHTINË, 1 KORRIK - Shqip Kamberi, i vetmi përfaqësues i shqiptarëve në Kuvendin e Serbisë, njoftoi të martën se ka vendosur ta bojkotojë Kuvendin serb në shenjë proteste ndaj, siç i përshkroi ai, krizës politike dhe institucionale në vend, mungesës së vullnetit politik për t'i respektuar të drejtat e njeriut dhe të pakicave, posaçërisht të shqiptarëve në Luginën e Preshevës.

Në “Facebook”, Kamberi renditi një sërë arsyes për të cilat tha se ka vendosur që “në këto rrethana nuk do të marr pjesë në punimet e ardhshme të Parlamentit të Serbisë”. “Duke pasur parasysh se komuniteti që përfaqësoj i qëndron besnik vetëm orientimit pro evropian të Ballkanit Perëndimor dhe beson fuqishëm në vlerat e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe barazisë; Duke u nisur nga fakti se respektimi i të drejtave të njeriut dhe të pakicave është themeli i çdo shoqërie të shëndoshë evropiane; Duke marrë parasysh vendimin e opozitës pro evropiane për të bojkotuar punën e Parlamentit si reagim ndaj krizës së thellë politike dhe institucionale në vend; Duke qenë dëshmitar çdo ditë i shkeljeve të vazhdueshme të të drejtave themelore të njeriut dhe të komuniteteve pakicë - në



veçanti të shqiptarëve, të drejtat e të cilëve vazhdojnë të nëpërkëmben prej dekadash, përkundër tre marrëveshjeve të nënshkruara me Beogradin (2001, 2009 dhe 2013); Mosnjohja e diplomave, nënpërfaqësimi politik dhe institucional, pasivizimi administrativ dhe mungesa e perspektivës ekonomike janë bërë pjesë e një agjende

sistematike që synon shpopullimin e Luginës së Preshevës nga shqiptarët; Duke vërejtur mungesën e plotë të vullnetit politik për të proceduar me nismat dhe iniciativat ligjore që do të përmirësonin pozitën e shqiptarëve në Serbi - të cilat tashmë prej muajsh mbeten të bllokuara në procedurat parlamentare”, ka thënë

Kamberi, duke shtuar se duke besuar se demokratizimi i Serbisë nuk është çështje e thjeshtë e ndërrimit të pushtetit, por kërkon vullnet të sinqertë për reformë, respekt për të gjithë qytetarët dhe trajtim të barabartë për të gjitha komunitetet; në fakt, sipas tij, demokratizimi i vërtetë mund të ndodhë vetëm kur, krahas ndërrimit të pushtetit, ndodh

edhe shkëputja përfundimtare nga politika imperialiste e viteve '90-ta. “Në këto rrethana, nuk do të marr pjesë në punimet e ardhshme të Parlamentit të Serbisë. Përfaqësuesit politikë shqiptarë ndër vite kanë ngritur zërin në Parlament duke folur në emër të të drejtave, barazisë dhe të ardhmes evropiane, duke kërkuar respektimin e normave themelore të të drejtave të njeriut dhe duke apeluar ndaj Bashkimit Evropian për zbatimin e marrëveshjeve të vitit 2001, 2009 dhe 2013 - fatkeqësisht pa sukses”, ka pohuar ai, duke theksuar se shoqëria vërtet pro evropiane mund të ndërtohet vetëm duke garantuar kushte të barabarta dhe trajtim dinjitoz për të gjithë - përfshirë shqiptarët. “Ajo nuk mund të ndërtohet mbi mitet e së kaluarës, as mbi trillimet historike dhe as mbi ambicien për hegjemonizëm në Ballkanin Perëndimor. Për veprimet e ardhshme politike do të njoftoheni me kohë. Të gjitha do t'i koordinojmë me aleatët tanë politikë dhe me të gjithë ata që vërtet besojnë në vlerat properëndimore dhe demokratike”, ka thënë Kamberi. Njoftimi i Kamberit vjen dy ditë pas një proteste masive antiqeveritare në Serbi, në të cilën pati përleshje me policinë.

Komanda e Forcave Tokësore e FSK-së realizon ushtrimin fushor "Tango Mike"

PRISHTINË, 1 KORRIK - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka njoftuar se në kuadër të përgatitjeve për validimin e Regjimentit të Tretë të Këmbësisë, kompania e armëve ka realizuar ushtrimin fushor "Tango Mike". "Në kuadër të përgatitjeve për validimin e Regjimentit të

Tretë të Këmbësisë, Kompania e Armëve ka realizuar ushtrimin fushor 'Tango Mike', me qëllim vlerësimin e kapaciteteve operacionale dhe aftësive taktike të togjeve, si dhe testimin e funksionimit të komandës dhe ndërlidhjes në kushte të ngjashme me ato

reale të betejës. Në këtë ushtrim janë validuar togjet e kompanisë, duke u vlerësuar në aspektin e dislokimit në terren, lëvizjes taktike, vendosjes në pozicione mbrojtëse dhe mbështetje më zjarre për njësitë operacionale të këmbësisë", ka njoftuar FSK-ja.



MBLEDHJA E SENATIT: TRI PROFESORESHA NË KËSHILLIN DREJTUES TË UP-së

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 1 KORRIK - Në mbledhjen e Senatit është zgjedhur pesëshja e Këshillit Drejtues që do ta përfaqësojë Universitetin e Prishtinës në këtë organ shumë të rëndësishëm ekzekutiv e rregullues. Tri nga pesë të zgjedhurit janë gra.

Anëtarët e UP-së në këtë këshill janë prof. Mimoza Ibrani, prof. Teuta Jashari-Kajtazi, prof. Arian Krasniqi, prof. Vjosa Fejza-Ademi dhe prof. Kurtesh Sherifi.

Në zgjedhje u votua për 16 kandidatë që, sipas Komisionit Zgjedhor, të përbërë nga prorektorja për zhvillim institucional, cilësi dhe çështje studentore, prof. Majlinda



Gjelaj, profesoresha e Fakultetit të Mjekësisë, Kreshnike Dedushi-Hoti dhe dekani i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sporteve, prof. Florian Miftari, i

plotësonin kushtet për të qenë pjesë e Këshillit Drejtues.

Në raundin e parë të zgjedhjeve anëtare e Këshillit Drejtues u bë profesoresha Mimoza Ibrani,

pasi mori më shumë se gjysmën e votave nga senatorët, gjithsejtë 23, ndërsa raundi i dytë i votimit u zhvillua me 12 kandidatët më të votuar nga

raundi i parë.

Katër anëtarët e tjerë të Këshillit Drejtues nga personeli akademik i Universitetit të Prishtinës u zgjodhën në raundin e tretë të votimeve, pasi në të dytin asnjëri prej tyre nuk mori votat e mjaftueshme. Këtë herë votimi u bë për tetë më të votuarit nga raundi i dytë. Mandati i pesë të zgjedhurve do të zgjasë deri më 14 shtator 2028. Thirrja për aplikim në këto pesë pozita ishte shpallur më 2 qershor, kurse ankesat eventuale për proceset e përzgjedhjes dhe votimit do të shqyrtohen mes 1 e 2 korrikut 2025.

Këshilli Drejtues, përveç pesë anëtarëve nga personeli akademik i UP-së, i ka edhe katër anëtarë që emërohen nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Inovacionit.

KQZ-ja PUBLIKON LISTËN ME 945 QENDRA TË VOTIMIT PËR ZGJEDHJET LOKALE 2025

PRISHTINË, 1 KORRIK - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve njofton se është publikuar lista e qendrave të votimit për zgjedhjet lokale për kryetarë të komunave dhe për kuvende komunale të cilat do të mbahen më 12 tetor 2025.

Sipas vendimit të KQZ-së, numri i qendrave të votimit në 38 komuna të Republikës së Kosovës në të cilat do të zhvillohet procesi i votimit është 945. Nga ky numër, 907 qendra të votimit do të shërbejnë për votimin e rregullt, ndërsaq në 38 të tjera, nga një për çdo komunë, do të shërbejnë vetëm për votimin me kusht.

Lista e qendrave të votimit është publikuar në uebfaqen e KQZ-së.



Të gjithë shtetasit e Kosovës me të drejtë vote mund ta mësojnë qendrën e tyre të votimit përmes platformës elektronike deri më 29 gusht 2025, qytetarët me të drejtë vote, nëse dëshirojnë mund ta ndërrojnë qendrën e tyre të votimit, duke e caktuar sa më afër vendbanimit të tyre.

KRYETARI I GJILANIT THOTË SE JANË REALIZUAR MBI 2 MILIONË EURO INVESTIME NË SHËNDETËSI

GJILAN, 1 KORRIK - Edhe në fushën e shëndetësisë në komunën e Gjilanit janë bërë investime të mëdha e të cilat kanë krijuar kushte dhe shërbime më të mira për kujdesin e qytetarëve.

Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, tha se shëndetësia dhe mirëqenia sociale janë shtyllë e qeverisjes sonë. "Mbi 2 milionë euro investime që përmirësojnë jetën e qytetarëve tanë: QMF e re në Lagjen Arbëria, Mamografi falas, Pap-test falas, laboratorë për analiza gjaku në 5 fshatra, kujdes paliativ - nga 2 në 5 ditë në javë", tha Alban Hyseni.

I pari i Gjilanit theksoi se kjo është qeverisja jonë për shëndetësinë, për



mirëqenien sociale, për Gjilanin që duam.

Me Blendin, studentin që ndryshoi imazhin e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit

PRISHTINË, 1 KORRIK - "Sot realizuam një foto të veçantë me Blendin Kallabën, studentin tonë të jashtëzakonshëm - krijuesin e palodhshëm pas imazhit modern të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit", ka njoftuar ky fakultet në faqen zyrtare në "Facebook". Sipas këtij njoftimi, pas dhjetëra videove, qindra

fotografive, dhjetëra dizajneve dhe pafund ideve kreative, Blendin ka qenë forca e qetë dhe zëri i padukshëm pas skenës, që e ka transformuar dukshëm paraqitjen e Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit. "Ai nuk ka qenë vetëm pjesë e procesit - ai ka qenë motori i tij, duke e udhëhequr me pasion,

përkushtim dhe profesionalizëm. Faleminderit, Blendin! Për çdo ide të guximshme, për çdo detaj të realizuar me dashuri dhe për çdo kontribut që ka lënë gjurmë. Fakulteti ynë është krenar me ty - dhe historia jote është tashmë pjesë e historisë sonë", ka njoftuar ky fakultet.



DhTIK kërkon zgjidhje urgjente për bllokimin e regjistrimit të automjeteve të bizneseve

PRISHTINË, 1 KORRIK - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë e Kosovës (DhTIK) shpreh shqetësimin e thellë me situatën e krijuar sa i përket regjistrimit të automjeteve. Që nga ditët e para kur bizneset hasën në pengesa për ta kryer procesin e regjistrimit, DhTIK është angazhuar për të gjetur një zgjidhje në lidhje me këtë çështje.

DhTIK ka njoftuar se “në takimin që kemi mbajtur me zyrtarë të Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe Policisë, nga kjo e fundit jemi njoftuar

që ata kanë pezulluar përkohësisht gjambat e trafikut për bizneset, vetëm në rastet kur rastet kur vozitësit e automjeteve nuk janë identifikuar, përderisa gjambat e bizneseve në rastet kur vozitësit janë identifikuar, mbeten në fuqi deri në zgjidhjen e kësaj çështje”.

“Zyrtarë të Dhomës kanë kërkuar që ky pezullim të aplikohet për të gjitha llojet e gjobave të bizneseve deri në gjetjen e një zgjidhje të drejtë dhe të përballeshme. Dhoma është jashtëzakonisht

e shqetësuar me qasjen që institucionet përgjegjëse kanë zgjedhur të veprojnë karshi kësaj situatë, duke bllokuar të gjithë flotën e automjeteve të një biznesi dhe jo automjeti, i cili është gjobitur. Kjo po pamundëson regjistrimin e të gjitha mjeteve të tjera që nuk kanë asnjë detyrim të papaguar. “Për ne mbetet e paqartë pse ky nen (Neni 89, paragrafi 4), nuk u aplikua nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit, (Ligji nr. 08/L-186 për Rregullat e Trafikut Rrugor) në muajin mars 2024, por tani”,



ka njoftuar DhTIK. DhTIK u bënë thirrje të gjitha institucioneve përgjegjëse që

të reflektojnë dhe të angazhohen për zgjidhjen e kësaj bllokade.

VETËM NË MUAJIN MAJ JANË REGJISTRUAR 1 333 NDËRMARRJE TË REJA

PRISHTINË, 1 KORRIK - Agjencia e Statistikave e Kosovës ka publikuar raportin mujor “Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike në Kosovë - maj 2025”.

Ky raport paraqet një pasqyrë të ndërmarrjeve të reja të regjistruara në vendin tonë, sipas sektorëve ekonomikë, madhësisë, formës ligjore dhe regionit.

Në muajin maj 2025 janë regjistruar 1 333 ndërmarrje të reja.

Ka një rritje prej 16.6 % krahasuar me muajin prill.



Gjithashtu, ka një rritje prej 43.3 % krahasuar me majin 2024. Regjioni i Prishtinës prin me 582 ndërmarrje të regjistruara. Aktivitetet ekonomike më të

pëlqyera gjatë këtij muajit ishin: Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave me 321 (24.1 %); Prodhim me 170

(12.8 %); Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike me 161 (12.1 %); Ndërtimtari me 143 (10.7 %); Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim me 129 (9.7 %) etj.

Në kategorinë “Mikro Ndërmarrje” (0 deri në 9 të punësuar) janë gjithsej 1 321 ndërmarrje të regjistruara, në kategorinë “Ndërmarrje të Vogla” (10 deri 49 të punësuar) janë gjithsej 11 ndërmarrje të regjistruara, në kategorinë “Ndërmarrje të Mesme” (50 deri 249 të punësuar) është vetëm 1

ndërmarrje e regjistruar, kurse në kategorinë “Ndërmarrje të Mëdha” nuk kemi ndërmarrje të regjistruara këtë muaj.

Sa i përket shtrirjes gjeografike të ndërmarrjeve të regjistruara në nivel të regjioneve: Regjioni i Prishtinës prin me 582 ndërmarrje të regjistruara (43.7 %), Regjioni i Ferizajt me 162 (12.2 %), Regjioni i Gjilanit me 147 (11 %), Regjioni i Mitrovicës me 119 (8.9 %), Regjioni i Prizrenit me 117 (8.9 %), Regjioni i Gjakovës me 103 (7.7 %), dhe Regjioni i Pejës me 101 (7.6 %).

TIRANA BËHET QENDRA E INVESTIMEVE PËR SIPËRMARRJET E REJA

TIRANË, 1 KORRIK - Në një mbrëmje të kuruar me elegancë, përmbajtje të lartë dhe ambicie të qartë për të ndërtuar një treg investimi të strukturuar në Shqipëri, Keiretsu Forum Southeast Europe (SEE) organizoi në Tiranë Pitch Day-in e radhës, një ngjarje që solli bashkë startup-et më premtuese nga Shqipëria dhe Kosova dhe investitorët më aktivë në skenën e angel investing.

Pas një përzgjedhjeje konkurruese, vetëm pesë startup-e arritën të fitojnë të

drejtën për të pitch-uar para një audience të përbërë nga investitorë engjëj, fonde të huaja dhe liderë të ekosistemit të inovacionit në Ballkan. Eventu u hap me një Fireside Chat të veçantë, ku Enrico Baldassarri, një emër me mbi tre dekada përvojë drejtimi në kompani si Johnson & Johnson, Revlon, Reckitt Benckiser dhe Procter & Gamble, ndau perspektivën e tij mbi rritjen e qëndrueshme, transformimin e biznesit dhe rëndësinë e guximit strategjik në sipërmarrje.



Biseda, e moderuar nga Ravik Mima, CEO i Keiretsu Forum SEE, solli vlera konkrete për investitorët dhe themeluesit e pranishëm.

Keiretsu Forum SEE, pjesë e rrjetit të themeluar në San Francisko dhe aktiv në 60+ kapituj në të gjithë botën, po ndërton me ritëm të shpejtë një

komunitet të përkushtuar investitorësh në Shqipëri e më gjerë në rajonin e Evropës Juglindore.

Me fokus të veçantë në fuqizimin e investitorëve vendas, përfshirjen e diasporës dhe krijimin e një grupi të dedikuar për gratë investitore, forumi po e pozicionon Tiranën si një nyje kyçe për inovacion dhe qasje në kapital duke u përkushtuar në ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme mes investitorëve dhe startup-eve.

AUV ndalon importin e gjedheve nga një zonë në Francë, shkak përhapja e sëmundjes së lëkurës

PRISHTINË, 1 KORRIK - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) ka njoftuar se është ndaluar importi i gjedheve dhe i lëkurës së tyre nga zona Auvergne-Rhone Alpes në Francë”, pasi është konfirmuar prania e sëmundjes LSD. “Duke ju referuar raportit të ADIS dhe WOAH për konfirmim të shpërthimit të sëmundjes gungore të lëkurës LSD, AUV nxjerrë masën e ndalës se përkohshme të importit të kafshëve të gjalla të llojit të ‘Gjedhit’ dhe nënprodukteve

(lëkurave) nga zona e ‘Auvergne-Rhone Alpes Francë’. Obligohen autoritetet për kontroll kufitar që të ndërmarrin të gjitha veprimet për zbatim të urdhrat të ndalesës me qëllim të ruajtjes së shëndetit të kafshëve në Kosovë. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë është në monitorim të vazhdueshëm të situatës mbi lajmërimet e sëmundjeve të kafshëve. Ne kohë realë është duke ndërmarrë masa me qëllim parandalimi të përhapjes ne

vendin tonë. Në linjë me vendet tjera Kosova është duke vepruar për parandalim të përhapjes se sëmundjes gungore të lëkurës. Vendimet dhe masat e vendosura janë në përputhje me obligimet që dalin nga aktet ligjore në fuqi dhe praktikatat ndërkombëtare të kufizimeve tregtare. Mbi çdo ndryshim të rrjedhës së përhapjes së sëmundjes, veprimet do të jenë në përputhje me protokollet e masave veterinarë për parandalim të përhapjes se sëmundjes”, ka njoftuar AUV.



‘DARKA E GABUAR’ PËRKOHSHMËRIA E PUSHTIMIT DHE E SISTEMEVE POLITIKE

Tema e rikthimit tek identiteti evropian është bërë tema e ditës. Trinia si një prej struktura të kulturës evropiane është kumti i romanit të Kadaresë “Darka e gabuar”. Kopertina e librit e fton lexuesin drejt një kodi mesianik komunikimi dhe e ngulit në mendjen e lexuesit verbin “Darkë”, si një dikotomi e pashmangshme me “Darkën e fundit të KRISHTIT”. Mjeshtri i kulturës shqiptare e ka në sua kulturën evropiane të popullit të tij. E gjithë vepra e tij përshkruhet me një epitaf të identitetit evropian të popullit shqiptar.

“Darka e gabuar” është ndër veprat më të arrira për nga identiteti, sa shqiptar aq edhe botëror, e marrë si një tejkyrje e labirinteve të mendjes shqiptare ndër shekuj e përpos saj, e përbashkëta me mendësinë e perandorive dhe fuqive të kohëve. Trinia si fenomen kristian i Europës mbështet në disa struktura simbolike si p.sh., qyteti i shpërfilljes së dy fuqive të tjera pushtuese të Italisë dhe të Gjermanisë me dy Gurametot, një i madh e tjetri i vogël, trinia e fenomenit të Lek Dukagjinit, me fenomenin e fjalëve të Veip Qorrit dhe kalaja e Shanishasë, motrës së Ali Pashë Tepelenës, po ashtu trinia e 300 gjyqtarëve të perandorisë me zonjllëkun e grave të Gjirokastrës me Remzi Kadarenë kumarxhinë, pse jo trinia e shtëpisë së doktor Gurametos së madh me gruan e vajzën, pa reshtur në dialogun mes kolonelit gjerman e Gurametos, e padyshim prania e muzikës së Shubertit. Ngasje të tjera padyshim janë tre hetuesit, dy shqiptar e një i huaj. Ka një dyzinë trinish në këtë roman dhe e paharrueshmja përrallë e gjyshes me ftesën e një kalimtarit të vdekur a jo. Trinia, e përdorur jo më kot nga Kadare në të gjithë dialogjet, kur bëhet fjalë për hebreun Jakuel është edhe bazamenti i identitetit kombëtar shqiptar, ku shkrimtari, ka një qendërzim të besueshmërisë të vetive më të mira të popullit shqiptar me kultin e besës përballë çdo kulture tjetër, të cilën e besojnë që nga studiuesi i shquar Karl Majer e deri tek koloneli sozie i mikut të Gurametos, gjermani Klaus Hepmfs apo hetuesi gjermano-lindor e ai rus. Por, doktori (Gurameto i vogël) është një nimfë e paparë e gjithë psikikës së qytetit, që veç fodullëkut, cinizmit, mbartëte edhe pesha mëkatesh, si në rrëmbime grash apo në s’di pse edhe namin e qytetit pritës të vezirëve, e mbesave të sulltaneshave, anipse edhe

kryetorturonjësve të perandorisë osmane. Ky qytet nxiste me vetëdije lojën e shemrave mes dy doktorëve aq të aftë profesionalisht e me një kulturë perëndimore italo-gjermane.

Mjeshtërisht shkrimtari është i akullt me palët, por i ka ndër-tuar këto përballje në antipode pa të cilin njëri personazh nuk bën pa tjetrin, e fati i njërit është edhe i tjetrit, ndryshe nga skemat linare të narracionit shqiptar. Përkohësia e pushtimit me përkohësinë e sistemit komunist është një ide fikse, fund e krye e këtij romani. Doktor Gurameto në ndërgjegjen e tij kombëtare është një shqiptar i ndershëm e padyshim me virtyte të një intelektualit atdhetar, nuk do që nga tradita e mirë shqiptare si mikpritja, besa e nderi i grave të cënohen.

Për doktorin janë toteme për të cilat mburret. Tri histori e lidhin romanin me Gurameton e madh e padyshim këtu e ka sharmin Kadare, tek rrëfimi i vjedhur i gjermanit Shvabe, shok shkolle i doctor Gurametos së madh, për Kanunin e Lek Dukagjinit, të mistershmen kulturë gjermane, enigmën e fesë përballë nacional-socializmit hitlerian. Vehip Qorri është pa sy. Një dëshmi më pak a do ta shpëtonte doktorin. Pse bejten e këtij të verbëri zinin vend në qytet e kush më shumë se Kadare do e destruktonte figurën e apologjisë: “më mirë syri sesa nam”. Këtu bëhet fjalë për një kod komunikimi e në këtë qytet fjala ka peshë sa pasthirrma e Vehip Qorrit që godet në kujtesën e doctor Gurametos së madh, si pesha e kryqit. Hetuesit shqiptarë, imitues të shkollës ruse të zbulimit janë triumvirat i botës së re, me ndryshim se fjalët e dishepujve për Krishtin, “o me ne o kundër nesh”, simbolizojnë kthimin e një bote të re.

Po ku ta dinë hetuesit komunistë, se nderi dhe e vërteta nuk kanë ideologji e parti? Të rënë nga vakti i zonjave të Gjirokastrës është një tragjedi pa kontekst. Çfarë të bënin me emrin e termave shoqe filankë apo “shoqe nesër kemi aksione a mbledhje”; rrokopuja e zotave ishte e pamëshirshme. Skeptri i shkrimtarit që hiperbolizon qytetin, jo me ftohtësinë e tij gjeografike ndaj zonave përreth, fshatrave e udhëve ndërkombëtare, por me mediatizimin, ku forca historike e tij është gravitet për burra shteti botërorë, si Duçja a Hitleri, Stalini apo Hrushovi. Komploti sekret e përfshin gjithë eposin psikologjik të këtij qyteti. Një e treta e botës e kishte mendjen tek e vërteta



e qytetarit të këtij qyteti. Rresht pas rreshti ka një simfoni të Shubertit “Vajza dhe vdekja” në darkën e gabuar, por ajo është fillesa e artit evropian në kristianizëm. Doktorin nuk është zoti që shpëtoi pengjet; trilli kadarean e ç’mizizon dhe e mbështjell me ëndrrën më të kobshme për ters të tijin, e cila e ndjek në frymëmarrjen e fundit si çelës masonik. Rrëfimi i sinqertë i një miku për një mik shkolle, se ëndrra në regjimin socialist ishte gati vetëvrasëse për t’ia besuar dikujt. Kur sekreti profesional përbën esencën morale të dr. Gurametos ajo ka kundërvënien sinqeritetin e hetuesit Shaqo Mezin. Pasoja jetë-vdekje nuk ka potencën e rrënimt të dr. Gurametos. Ai përsoset në infinit si një figurë engjëlllore e lartësuar pas 40 vjetësh. “Paranoja e paragjykimi, urrejtja e dashuria për një njeri në këtë qytet ishte gjuha e një njeriu që kish humbur toruan”, – thotë Kadare. Askushi, i vdekur apo i ringjalluri, sikur të të vjedhin passwordin po e po, por mbi të gjitha sinqeritetin, pasurinë e kujtimeve dhe ëndrrave është fabula e kësaj veprë. Si “Askushi” i Odisesë përballë Ciklopit endet në vepër një i vdekur i gjallë si kolonel Shvabe. Ka darka e darka si në tragjedinë e Shekspirit(ëndrra e Hamletit). Narrator Kadare është në terrenin e vet, është ringjallje e personazhit, e Qytetit apo e Shqipërisë; kjo ka

diskursin e vet magjik, të emetuar si shkolla Kadare. Ndërkaq bashkë me tingujt e gramafonit valë, valë shpërndahej tortura e shpjegimit të darkës. Qyteti nuk ishte një humbamento që habitej prej vizitave. Pas mpirjes së parë, kur pas ëndrrës për të qenë në majë, qyteti po binte në gropë të botës, pyetjet binin si breshër, pse? Stalini s’do të vinte. Si krijim individual gjuhësor kjo vepër letrare e ka ndjeshmërinë dhe intelektin e përcjellë mjeshtërisht nga Kadare nëpërmjet kuptimeve të figurshme. Kompozicioni i kësaj veprë e ka vullën e karakterit letrar deri në detaje, si formë e pandarë zhbirimi epistemologjik shqiptar (mënyra e të menduarit dhe të kuptuarit), qoftë në qytetin e Gjirokastrës, apo kudo ku është hapësira shqiptare në botë.

Intriga e gdhendur mjeshtërisht nga shkrimtari i madh Ismail Kadare nëpërmjet konfliktit të qytetit me shpërfilljen ndaj të huajve, konflikti mes moralit të Gurametos me opinionin e qytetit, e të mos harrojmë konflikti i regjimit komunist me qytetarin patriot, intelektualin botëror doktor Gurameton e madh e të vogël, kultura perëndimore e doktorëve me ideologjinë komuniste. “Mënyra e pritjes bëhet kushti bazë për të vërtetën: e vërteta, këtë na e dëshmon narrativja, është ajo që mbetet në fund të pritjes”. Kjo thënie, sipas Barthes, na çon në kodin

hermeneutik të romanit “Darka e gabuar”. E vërteta lidhet me mbarimin e leximit, kur lexuesi mund të bëjë vetë konkluzionin. Edhe për darkat e lartpërmendura në fillim të shkrimit konkluzionin e bëjnë vetë qytetarët shqiptarë, por pa kënaqësinë e të lexuarit të letërsisë artistike.

BE pulsoi në mënyrë diplomatike paragjykimin e vet konstant, si dikur i madhi studiues gjerman Karl Mayer, ndoshta për të na kujtuar ne shqiptarëve se sa pak volume librash, artikujsh, filmash e performanca evropiane kemi ekspozuar në këto 82 vjet si politikë. Shterpwsia e performancës evropiane tonë në espozimin e frymës evropiane të kulturës shqiptare, nuk munda të mbushej në këto vite. Strategjitë e përdorura dështuan. Rilindja e një epistemologjie shqiptaro-evropiane duhet të jetë e gatshme me shembuj e veprime, të të gjithë shqiptarëve, qoftë këta artistë apo zyrtarë, të cilët punojnë e jetojnë në vendet e familjes evropiane me dinjitet dhe identitet të rishfaqet me të gjithë potencialin e vet. Martesat e shqiptarëve me shtetas të këtyre vendeve e plotësojnë mozaikun si kurrë ndonjëherë përpara çdo diskursi të mediave të huaja apo pse jo dhe kancelarive evropiane.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Hapet afati kalimtar veror në hendboll

PRISHTINË, 1 KORRIK - Bordi i Federatës së Hendbollit të Kosovës ka vendosur që afati i rregullt kalimtar veror të jetë i hapur prej 1 deri më 15

korrik. Vendimin për afatin kalimtar, që është hapur sot (e martë), Bordi e mori duke u bazuar në Rregulloren për Regjistrimin e Lojtarëve dhe

Statusin e tyre. “Pritet që afati të jetë i pasur, me lëvizje të shumta të lojtarëve. Klube dhe lojtarë të ndryshëm tashmë kanë paralajmëruar

ndryshime, ndërsa ato pritet të bëhen zyrtare gjatë afati që do të jetë i hapur deri në mes të korrikut”, thuhet në njoftimin e FHK-së.



Sot fillon Kampionati Evropian U16 i Volejbollit, organizohet në Prishtinë e Tiranë

“Epoka e re

PRISHTINË, 1 KORRIK - Federata e Volejbollit e Kosovës, në bashkëpunim me Federatën e Volejbollit të Shqipërisë, do ta organizojë Kampionatin Evropian U-16 për vajza, i cili prej 2 deri më 13 korrik 2025 mbahet në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë dhe në Tiranë. Kjo është ngjarja më e madhe ndërkombëtare e volejbollit e zhvilluar ndonjëherë në Kosovë dhe një prej ngjarjeve më të mëdha në sportin e Kosovës, që përfaqëson një moment historik për sportin dhe komunitetin tonë. Vashat e Kosovës e nisin kampanjën ndaj Malit të Zi, takim ky që nis në orën 20:00 dhe që pritet të mbledhë numër të madh shikuesish. Kosovën U-16 e ka vizituar në

përgatitje edhe zëvendësministria në detyrë për Kulturë, Rini e Sport, Daulina Osmani. Vizita e saj ishte një dëshmi e qartë e mbështetjes së plotë të MKRS-së, e cila ka qenë thelbësore në të gjitha etapat e organizimit dhe përgatitjeve për këtë kampionat të jashtëzakonshëm. “Në adresimin e saj drejtuar vajzave të kombëtares, Osmani i inkurajoi të japin më të mirën dhe të përfaqësojnë me krenari Republikën e Kosovës në arenën evropiane. Osmani u prit nga presidenti i Federatës së Volejbollit të Kosovës, Bahri Gjinovci, sekretari i përgjithshëm Valon Nikqi, si dhe anëtarët e bordit Gezim Brahimi dhe Gentiana Beqa, të cilët e falënderuan për përkrahjen e jashtëzakonshme të ofruar nga MKRS në të gjitha format. Kjo mbështetje financiare ka qenë 100 % e



garantuar dhe vendimtare për realizimin e këtij projekti madhor”, thuhet në njoftimin e FVK-së.

Në grupin (B) e Kosovës janë edhe Kroacia, Republika Çeke,

Greqia, Hungaria, Mali i Zi, Sllovenia dhe Turqia. Shqipëria ndodhet në Grupin A, së bashku me Bullgarinë, Francën, Italinë, Lituaninë, Poloninë, Spanjën dhe Ukrainën. Pikërisht Kosova

dhe Shqipëria kanë luajtur dy ndeshje miqësore para nisjes së Evropianit, derisa bashkërisht kanë vizituar edhe kompleksion memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

Sot shorti për Trepçën në Ligën e Kampionëve



MITROVICË, 1 KORRIK - Liga e Kampionëve e Basketbollit po hyn në edicionin e 10, duke filluar me shortin e Turneve të Raundit të Kualifikimit dhe edicionit të rregullt të mërkurën. Shorti do të transmetohet në faqen e Ligës së Kampionëve në basketboll, më 2 korrik, nga ora 12:00. Kampionia e Kosovës, Trepça, është në vazon e dytë.

Njëzet e katër (24) ekipe do të garojnë në tre (3) turne të raundit kualifikues. Të tre turnetë e Raundit Kualifikues do të zhvillohen në fund të shtatorit. Orari i ndeshjeve, si dhe vendi i zhvillimit, do të shpallen më vonë në korrik. Të tre turnetë e

raundit kualifikues do të luhen në format eliminues me një ndeshje të vetme, duke filluar nga çerekfinalet. Ekipet nga Vazo 1 do të përballen me ekipet nga Vazo 4, ndërsa ekipet nga Vazo 2 do të përballen me ekipet nga Vazo 3. Tre fituesit e turneut të raundit kualifikues do të avancojnë në grupet e edicionit të rregullt. Edicioni i rregullt do të ketë tetë grupe me nga katër ekipe. Trepça edicionin e kaluar ishte në kualifikimet e Ligës së Kampionëve, ndërsa më pas pjesë e grupeve të FIBA Europe Cup. Mitrovicasit fituan titullin, Kupën dhe Superkupën në edicionin e kaluar.

Koshi, besnik i Vëllaznimit

GJAKOVË, 1 KORRIK - Kapiteni Atik Koshi është treguar besnik ndaj skuadrës së Vëllaznimit nga Gjakova. Kuqezinjtë kanë njoftuar se kapiteni do ta djersijë

fanellën e tyre edhe në edicionin e ri basketbollistik. “Koshi do të vazhdojë të shënojë në Gjakovë! Kapiteni Atik Koshi mbetet në fole edhe për një edicion tjetër,

duke ju qëndruar besnik ngjyrave kuqezi! Marrëveshja me Atikun s'ka qenë fare problem, duke marrë parasysh lidhjen e ngushtë të lojtarit dhe

paraqitjet e mira me ekipin nga vendlindja, andaj me kënaqësi ju njoftojmë se mbetemi bashkë për një tjetër sezon”, thuhet në njoftimin e Vëllaznimit.



Daku, lojtari më i paguar i Shqipërisë, siguron miliona euro në Rusi

TIRANË, 1 KORRIK - Mirind Daku ka rinovuar kontratën me Rubin Kazanin, duke arritur një marrëveshje të re që do ta mbajë në klubin rus deri në vitin 2029. Sipas medieve ruse, sulmuesi 27-vjeçar i kombëtares shqiptare do të përfitojë 3 milionë euro

në sezon me kontratën e re, shumë kjo që përfaqëson një rritje të ndjeshme në krahasim me kontratën e mëparshme, ku përfitonte 700 mijë euro në vit. Rinovimi i Dakut vjen mes spekulimeve për një transferim të mundshëm te

Zeniti. Sipas raportimeve, Zeniti kishte arritur marrëveshje me Rubin Kazanin për transferimin e tij, por negociatat kishin ngecur. Daku kishte refuzuar ofertën e klubit nga Shën Petersburgu, e cila i ofronte

një pagë prej 2.2 milionë eurosh në sezon. Sulmuesi shqiptar kishte kërkuar 3.5 milionë euro në vit, kërkesë që Zeniti nuk kishte pranuar ta përmbushte. Përfundimisht, Daku ka zgjedhur të qëndrojë në Kazan, ku jo vetëm që do të



luajë një rol të rëndësishëm në skuadër, por do të përfitojë edhe një kontratë shumë më të favorshme.

Drejtori i Leverkusenit: Xhaka është një lojtar i rëndësishëm për ne

LEVERKUSEN, 1 KORRIK - Drejtori sportiv i Bayer Leverkusenit, Simon Rolfes, në një intervistë të gjatë dhënë për "Kölner Stadt-Anzeiger", foli rreth interesimit të Milanit për Granit Xhakën. "Ne mbetemi të përqendruar te faktet. Ndonjëherë kjo ndihmon në botën e sotme. Janë bërë shumë spekulime për një kalim të supozuar të tij te Milani, por nuk ka pasur asnjë negociatë. Pas ndeshjes së fundit të sezonit në Mainz i thashë Granitit se mbetet një lojtar i rëndësishëm për ne. Kjo qasje e jona nuk ka ndryshuar", ka thënë Rolfes. Granit Xhaka, mesfushor kosovar, i lindur më 1992, është i njohur për vizionin e tij të lojës, pasimet e gjata të sakta dhe goditjen e fuqishme. Karrierën profesionale e nisi te Baseli, ku fitoi dy kampionate zvicerane (2010-11, 2011-12) dhe një Kupë të



Zvicrës (2011-12), duke u afirmuar si një talent i ri. Më 2012 kaloi te Borussia Mönchengladbach në Bundesligën, ku luajti 140 ndeshje në 4 sezone dhe u bë shtyllë e mesfushës. Hapi i madh erdhi më 2016, me kalimin tek Arsenali në Premierë Ligë. Në 7 vitet në Londër zhvilloi 373 ndeshje, shënoi 23 gola dhe fitoi dy "FA Cup" (2017, 2020) dhe dy

"Community Shield" (2017, 2020), duke mbajtur edhe shiritin e kapitenit. Në vitin 2023 u rikthye në Bundesliga me Bayer Leverkusen, ku pati menjëherë ndikim të madh, duke kontribuar në fitoren historike të kampionatit gjerman në sezonin 2023-2024. Ai është, gjithashtu, lider dhe shtyllë e kombëtares së Zvicrës, me mbi 130 paraqitje dhe shiritin e kapitenit.

Ish-pronari i Formulës 1: Hamiltoni nuk ka për ta fituar kurrë titullin e tetë kampion bote

VJENË, 1 KORRIK - Në moshën 94-vjeçare e 8 muaj, Bernie Ecclestone, ish-pronari i Formulës 1, u ngjiti në një podium të F1 për herë të parë në jetën e tij. Rasti iu dha ditën e diel në pistën austriake të Spielbergut, kur i dha fituesit medaljen e zakonshme të Federatës. "Në pamundësi për të marrë pjesë në garën e Austrisë, presidenti më kërkoi të dorëzoja medaljen, gjë që jam i kënaqur dhe i nderuar ta bëja. Ishte fantastike edhe nëse mund të duket e çuditshme. Kjo ishte hera e parë në pothuajse 70 vjet të këtij sporti që kam qëndruar në podium! Pra, edhe kjo ishte e këndshme", ka thënë Ecclestone. I pyetur nëse Lewis Hamilton do ta fitonte ndonjëherë titullin e tij të tetë botëror, ai tha: "Jo. Mendoj



se në jetën e secilit ka periudha në të cilat gjithçka shkon mirë dhe mendoj se ai pati fatin të gjente veten përpara kur nuk kishte shumë konkurrencë dhe për këtë arsye gjithçka ishte më e lehtë". "Tani ai ka kundërshtarë.

Shpresoj që ai të mund ta përfundojë misionin e tij, por nga këtu deri te realizimi i saj është një histori krejt tjetër", ka shtuar Bernie Ecclestone, që nuk ka pasur marrëdhënie të mira me shtatë herë kampionin e botës.

SHKURT

Ballkani konfirmon largimin e Quevenit

Ballkani ka konfirmuar se futbollisti Queven Inacio është larguar nga skuadra derisa e ka falënderuar për kontributin dhe i ka uruar suksese në vazhdim të karrierës. "Falënderojmë lojtarin Queven Inacio për kontributin dhe përkushtimin e treguar gjatë kohës sa ishte pjesë e klubit tonë FC Ballkani. Queven ka dhënë gjithmonë maksimumin në fushë dhe ka qenë pjesë e rëndësishme e skuadrës sonë. Jemi mirënjohës për punën, karakterin dhe profesionalizmin që ka shfaqur gjatë gjithë kohës. FC Ballkani i dëshiron Inacios suksese të mëdha në vazhdim të karrierës", thuhet në njoftimin e Ballkanit.

Guardiola pas eliminimit: Mëkat, duhet të ishim cinikë

Botërori për Klube i vendosi "vulën" një sezoni të dështuar nga ana e Manchester Cityt. Pep Guardiola ndjen keqardhje për këtë humbje nga Al Hilali (4-3), pasi në sytë e tij ekipi prodhoi shumë. "Është mëkat. Në këtë pikë të turneut të gjithë ndeshjet janë të vështira. I lejuam atyre të krijonin shumë në trazicion, por edhe ne krijuam shumë, në përgjithësi u treguam të zotë, por portieri i tyre bëri disa pritje fantastike. Nuk kam çfarë të them më shumë, në ndeshje të tilla duhet të jesh cinik. Ndjesitë janë se skuadra po ecën mirë, tani rikthehemi në shtëpi, kemi kohë për të pushuar, për t'u rifreskuar dhe të rikthem sezonin e ri", ka thënë Guardiola.

Inzaghi: Ndaj Cityt djemtë e vendosen zemrën në fushë

Trajneri i Al Hilalit, Simone Inzaghi, është ndarë i kënaqur pas suksesit ndaj Manchester Cityt në Botërorin e Klubeve. Skuadra e tij arriti ta eliminojë nga kjo garë Cityn e Pep Guardiolës. "Çelësi i suksesit i këtij rezultati ishin djemtë, vendosen zemrën në fushë. Ne ishim të detyruar të bënim diçka të jashtëzakonshme pasi e dinim se sa i fortë është ekipi i Manchester Cityt. Duhet të kalonim një mal si Everesti pa oksigjen, por u treguam fantastikë. Pep Guardiola? Ai është trajneri më i mirë në botë, por këtë mbrëmje ne bëmë më të mirën tonë dhe e merituam këtë rezultat", u shpreh Inzaghi.

Napoli synon transferimin e Mullerit

Pas transferimit të bujshëm të Kevin De Bruyne, Napoli po synon një tjetër lojtar me përvojë të madhe. Bëhet fjalë për mesfushorin gjerman Thomas Muller. Sipas "Fichajes", klubi italian po përpiqet ta bindë 36-vjeçar, i cili do të largohet nga Bayern Munich pas Kupës së Botës për Klube, pas 25 vitesh në klub, të transferohet në Itali, te skuadra kampione e Napolit. Mulleri nuk ka në plan të pensionohet dhe është i hapur për një përvojë të re, ndoshta edhe në Serinë A.

Carvajal rikthehet pas 9 muajsh në fushë

Makthi ka përfunduar për Dani Carvajalin. Mbrojtësi i Real Madridit është jashtë prej nëntë muajsh, pasi këputi ligamentet në muajin tetor.

Rikuperimi pas operacionit ka shkuar mirë dhe spanjoli e ka hedhur pas krahëve dëmtimin. Rikthimin e konfirmoi vetë lojtari, që u

shpreh se është gati të luajë ku dëshiron trajneri, madje edhe si portier. "Pas nëntë muajsh jam gati të luaj sërish. Nuk e kam problem të luaj si

mbrojtës qendre, në një mbrojtje me tre lojtarë. Luaj ku të dojë trajneri, madje edhe si portier", ka thënë Carvajal. Mbrojtësi i djathtë do të

përballet me një konkurrencë të fortë për fanellën e titullarit, pasi këtë verë Real Madridi firmosi me Trent Alexander Arnold.



REGIONALNO PREDUZEĆE ZA OTPAD "Pastrimi" A.D

Na osnovu Zakona o radu br. 03 / L-212, posebno člana 8, u Uredbi br. 07/2024 o radnom odnosu u RPO "Čišćenje" a.d., tačnije članovi 11. i 12., u Uredbi br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u RPO "Čišćenje" a.d. A kao i u Dodatku – Izmena i dopuna Uredbe br. 01/2024 odobren 01.07.2025. godine sa protokolom broj 01/14/26 tačnije član 1. i 2. radna mesta radnika u saobraćaju i radnika u javnoj higijeni izuzeta su od kriterijuma radnog iskustva, Odlukom br. 7096 od 15.11.2024. godine i članom 20. tačka 2. Uredbe 07/2024, ova radna mesta su izuzeta od testiranja i na osnovu Rešenja od 26.06.2025. godine sa brojem protokola 02/01/483 izvršnog direktora RPO "Čišćenje" SH. A, objavite ovo:

KONKURS JAVNO
Za popunjavanje posla

Naziv posla:	Transportni radnik u RPO "Čišćenje" A.D
Ne. Obavezno:	Dvadeset (20) pozicija, Operativna jedinica Priština
Referentni broj:	NJOPR/KJ/15/2025
Koeficijenti / Mesečne plate:	Nivo XIII
Trajanje ugovora o radu:	Sa neodređenim vremenom
Probni rok:	3 meseca

1. Dužnosti i odgovornosti:

- Sakupljali su smeće u određenim oblastima;
- Ispraznili su kontejnere u vozilu / kamionu;
- Uradili su čišćenje prostora oko kontejnera;
- Na osnovu operativnog plana i radnog naloga, očistili su i oprali ulice i trotoare;
- Očistili su trotoare i ulice od snega i bacali so;
- Uklonili su mrtve životinje sa puta i stavili ih u odgovarajući kontejner;
- Odgovoran je za ljubaznost prema građanima i korisnicima usluga kompanije;
- Odgovorno je da se nakon sakupljanja otpada kontejneri postavljaju na prethodno mesto;
- Brine se i odgovoran je za pažljivo korišćenje radnih alata i kontejnera;
- On takođe obavlja i druge zadatke sa kojima ga vođa angažuje;
- O svom radu izveštava šefa Transportne jedinice u Prištini.

2. Opšti kriterijumi za prijem na funkciju:

- biti državljanin Republike Kosovo,
- da poseduju najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- Biti e/sposoban za obavljanje relevantne dužnosti;
- Da ne bude osuđen za izvršenje krivičnog dela;
- Ne bi trebalo da postoji disciplinska mera na snazi za ozbiljne prekršaje u javnoj ustanovi;
- Imaju obrazovanje, profesionalno radno iskustvo i / ili veštine potrebne za poziciju
- Da uspešno prođe procedure prijema utvrđene u zakonu.

3. Opšti formalni zahtevi

- Potrebno obrazovanje: Srednje ili osnovno obrazovanje

4. Znanje, veštine i kvalitete potrebne u postupku zapošljavanja

- Vještine logičkog zaključivanja i analize;
- Komunikacijske veštine i lični uticaj, uključujući sposobnost predstavljanja.
- Istraživanje, analitičke, evaluativne veštine i formulisanje stručnih preporuka i saveta;
- Sposobnost donošenja nezavisnih stručnih presuda i diskrecionog prava o pitanjima i davanja značajnog doprinosa razvoju i sprovođenju politike;

- Opsežno poznavanje oblasti, istraživačkih metoda, što pomaže u pripremi osnovnih ili analitičkih izveštaja;

5. Dokumenti koji se podnose u okviru prijave i kako ih dostaviti

Prijava popunjena i potpisana od strane kandidata	✓
CV - u	✓
Kopije diploma koje dodeljuju obrazovne ustanove	✓
Kopija dokaza o zaposlenju (penzioni fond, potvrda ili ugovor o radu)	✓
Kopija sertifikata o obuci i kursu (poželjno)	✓
Kopije procena posla za poslednje dve godine (poželjno)	✓
Kopija lične karte/pasoša/uverenja o državljanstvu Republike Kosovo	✓
Dokaz da nije osuđen za krivično delo, NE starije od 6 meseci	✓

6. Kako se prijaviti na takmičenje:

- 6.1 Povlačenje službenih obrazaca se vrši:
- preuzimanjem sa zvanične stranice na društvenoj mreži Facebook: Regionalna kompanija za otpad "Čišćenje" AD.
 - u Kancelarijama za ljudske resurse RPO "Čišćenje" a.d.
- 6.2 Podnošenje prijave vrši:
- samo elektronskim putem preko adrese: punesimi.krmpastrimi@gmail.com i
 - u fizičkom obliku u slučajevima tehničkih pozicija.

7. tačan datum i vreme zatvaranja javnog konkursa;

Javni konkurs traje 15 dana od 02/07/2025 do 16/07/2025.

Poslednji put za prijem prijava je 16:00 časova.

Sve prijave koje stignu nakon isteka roka neće se razmatrati.

8. Metod procene i kriterijumi ocenjivanja.

Kandidati se ocenjuju na osnovu biografije, pismenog testa i intervjua (usmeni test).

- CV kandidata se ocenjuje do dvadeset pet (25) bodova;
- Intervju (usmeni test) se ocenjuje do sedamdeset pet (75) bodova.

Postupak vrednovanja sadrži ukupno sto (100) bodova, pri čemu je prolaznost postizanje najmanje pedeset pet (55) bodova iz svih faza Javnog konkursa.

9. Kako obavestavati i komunicirati sa kandidatima.

Svi kandidati će biti obavesteni putem elektronske komunikacije i pojedinačno.

10. Približan kalendar postupka zapošljavanja:

Faza pre verifikacije aplikacija do 7 dana;

Faza pismenog testa do 10 dana nakon faze verifikacije,

Faza intervjua do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa.

Objavljivanje rezultata do 5 dana nakon evaluacije intervjua.

Napomena: Nepotpuna, neskenirana dokumenta, kao i ona koja stižu nakon isteka roka konkursa neće biti razmatrana.



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjibiznesi.com,
Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878 info@kolegjibiznesi.com

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë dhe Dega në Prizren:

Kolegji Biznesi shpall konkursin publik të rregullt për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj për vitin akademik 2025/2026, në të gjitha programet e studimit të akredituara nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës dhe të licencuara nga MASHT.

Të drejtë aplikimi dhe regjistrimi në studimet themelore (Bachelor) e kanë të gjithë kandidatët që e kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë dhe që e kanë përfunduar me sukses testin kombëtar të maturës. Kurse ne studimet Master kanë të drejtë aplikimi dhe regjistrimi të gjithë kandidatët që i kanë përfunduar Studimet Bachelor.

Studime Bachelor

1.Banka dhe Financa në Biznes (Ba) - (3 Vjeçar)
2.Menaxhment dhe Ekonomiks (Ba) - (3 Vjeçar)
3.Menaxhimi i Emergjencave (Ba) - (3 Vjeçar)
4.Juridik / LLB - (4 Vjeçar)
5. Shkenca Kompjuterike Bsc - (3 Vjeçar)

Studime Master

1.Menaxhment dhe Financa – MA-(2 Vjeçar)
2.Menaxhimi i Emergjencave – MA-(2 Vjeçar)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Bachelor, i bashkëngjisin aplikacionit:
➤ Certifikata e maturës shtetërore – origjinale ose kopje e noterizuar;
➤ Diploma e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
➤ Dëftesat e shkollës së mesme – origjinale ose kopje e noterizuar;
➤ Ekstrakti i lindjes;
➤ Kopje e letërnjoftimit;
➤ 2 fotografi (formati pasaportë)

Studentët të cilët aplikojnë në studimet Master, i bashkëngjisin aplikacionit:
➤ Diplomën ose certifikatën e fakultetit (të noterizuar)
➤ CV
➤ Certifikatën e lindjes
➤ Kopjen e letërnjoftimit
➤ Dy foto

038/045- 500 878 : 029-230-555
044/ 049/ 048- 500 – 878



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjibiznesi.com, info@kolegjibiznesi.com
Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: 30.05.2025, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë:

SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK

I. PROFESORA
1. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Ekonomik**,
2. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Juridik**,
3. **Dy (2)** mësimdhënës në programin - **Menaxhimi i Emergjencave**,
4. **Një (1)** mësimdhënës në programin – **Shkenca Kompjuterike**,

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të Kolegjit Biznesi.

Për vendin e punës mësimdhënës, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatëse dhe punime në revistat si SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE.

Njohja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar (vërtetuar), Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.

Kandidatët që kanë doktoruar jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga **18.06.2025 deri më 30.06.2025**.

Paraqitja e dokumenteve: Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, 10000 Prishtinë, Kosovë ose përmes e-mail: info@kolegjibiznesi.com

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: www.kolegjibiznesi.com

Aplikacionin mund ta shkarkoni në ueb faqen: www.kolegjibiznesi.com ose mund ta merrni në zyrat e Kolegjit Biznesi.

NJOFTIM

Njoftojme te githe klientet se Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "Kos Defense” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marre vendim te shuajë biznesin me nrb UNIK: 811422112, dhe ka caktuar likuidatorin per zhvillimin e procedures se Likuidimit. Njoftohen te githe klientët qe kane raporte Kreditore - Debitore ne këtë korporate që te paraqiten ne afatin 30 ditor nga data e shpalljes ne gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Kos Defense" D.O.O. od Prishtina donelo odlukuo prestani rada sa nrb: 811422112, ujedno imenovao Likvidatorao sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavijivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Kos Defense" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811422112, the company has appointet a liguidator who is going to oversee the liguidator process. All clients who have the mort-gager - mortgage accounts in this company are kindly request to showup within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Ariani Home” SH.P.K. me nr. Unik Identifikues: 811926271 Vushtrri, shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330596984.

- Hyrije Fejza B.I. shpall te pavlefshme arkën fiskale me nr. unik: 811281790.

- Shemsie Lahu shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Ismail Qemali”.

- Jeton Xhafiqi shpall të pavlefshme patentë shoferin (lejen e kerrit) Piranë Prizren.

- Aleksandar Mihajlovic shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 81070307.

- Kujtim Zeneli shpall te pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme të gjimnazit “Frang Bardhi”.

- Lule Osmani shpall të pavlefshme diplomën e sh,m, të Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



ROYAL CROWN

RC
cola

**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

RC
cola

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

